




Pranimi / Donesor Pratpasa / Pr. d. no. Received / Delivery	07-04-2022	2	viti god year
Organ / Qesta Organ / Jedinita Org / Unit	B. Prot B. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTICK	1956/2022		117



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.151/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi - Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.151/2022 të datës 16.02.2022 të parashtruar nga ankuesit:

e regjistruar në emër të ankuesit Iset Lahu, të përfaqësuar me autorizim nga Avokat me adresë:

Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, në çështjen juridike “kompensim material” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, 1.3 si dhe nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.151/2022 e datës 22.02.2022 e parashtruar nga ankuesit:
- II. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.151/2022 e datës 22.02.2022 e parashtruar nga ankuesit dhe ndërsa obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore që ankuesve të ua bëjë kompensimin për shpërblimin e përvjetorit (jubile).
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet JO KOMPETENT për të vendosur për ankesën me numër A.nr.151/2022 të datës 22.02.2022 të parashtruar nga ankuesit:

IV. **OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, që të kujdeset për zbatimin e pikës II si në **dispozitiv** të këtij vendimi, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesit, sipas shkresave të lëndës të punësuar në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, me datë 10.01.2022 kanë parashtruar kërkesë te Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave të Kosovës, ndërsa për shkak të heshtjes administrative të institucionit me datë 22.02.2022 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokoll: 927/2022 me pretendimin ankimore që tu paguhet në mënyrë retroaktive të gjithë ankuesve shujta ditore me kamat ligjore 8% prej vitit 2014 sipas dispozitave ligjore të Ligjit Nr.04/L-230 të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, si dhe tu paguhet paga jubilarë ankuesve dhe

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.02.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave. Ndërsa Këshilli me datë 15.03.2022 ka pranua nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave përgjigjen në kërkesë me numër protokoll:1356/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr.prot:927/2022 të datës 22.02.2022 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 10.01.2022 të parashtruar tek Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave me listën e bashkangjitur të ankuesve; Autorizimin e datës 22.11.2021 për ankuesin

Akt emërimit e ankuesit	të datës 25.06.2017; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit	
Autorizimin e datës 22.11.2021 për ankuesin	Akt emërimit e ankuesit	datës
22.01.2018; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit	Autorizimin e datës 22.11.2021 për ankuesin	
Akt emërimit e ankuesit	të datës 01.02.2013; Kopjen e letërnjoftimit të	
ankuesit	Autorizimin e datës 22.11.2021 për ankuesin	Akt emërimit e
ankuesit	të datës 09.03.2016; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit	Autorizimin
e datës 22.11.2021 për ankuesin	Akt emërimit e ankuesit	të datës 31.01.2013;
Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit	Autorizimin e datës 22.11.2021 për ankuesin	
Akt emërimit e ankuesit	të datës 24.10.2018; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit	
Autorizimin e datës 22.11.2021 për ankuesin	Vendimin e datës 01.03.2020 për ankuesin	
me numër Nr.18; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit	Autorizimin e datës	
22.11.2021 për ankuesin	Vendimin e datës 20.02.2014 për ankuesin	me e-mailin
e bashkangjitur; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit	Autorizimin e datës 22.11.2021 për	
ankuesin	Akt emërimit e ankuesit	të datës 01.02.2013; Kopjen e letërnjoftimit të
ankuesit	Autorizimin e datës 22.11.2021 për ankuesin	Akt emërimit e ankuesit
të datës 01.02.2013; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit	Autorizimin e datës	
22.11.2021 për ankuesin	Akt emërimit e ankuesit	të datës 01.02.2013; Kopjen e











Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil nuk përcaktohet kompensimi apo pagesa e shujtës ditore për ditë pune për nëpunësit civil.

Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave në përgjigjen e dhënë Këshillit me datë 15.03.2022 me provat e bashkangjitura të lëndës, ka sqaruar se ndërlidhur me nenin 13 të Ligjit Nr.04/L-230 të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, nuk është nxjerrë apo mungon akti nënligjor që do ta rregullonte apo përcakton mënyrën e kompensimit të shujtave ditore, ndërsa ankuesit në sqarimet shtesë lidhur me pretendimin ankimor kanë specifikuar se, citoj: *“Sa jam në dijeni shujta ditore prej 3 euro për ditë pune, punëtorëve të AME ju është paguar herën e fundit për vitin 2011 e nga ky vit kompensimi për shujtë ditore nuk është paguar punëtorëve”*, nga rrjedh se pagesa për shujtën ditore për ditë pune për punëtorët e Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave është paguar para hyrjes në fuqi të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil e cila në mënyrë të detajuar e ka përcaktuar mënyrën, kushtet dhe kriteret e realizimit të shtesave të përcaktuara Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil i cili është në fuqi nga data 10.07.2010.

Kolegji pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesve dhe pasi ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil dhe Ligjit Nr.04/L-230 të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, ka gjetur se neni 13 i Ligjit Nr.04/L-230 të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent iu njeh të drejtën në kompensim e shujtës ditore për ditë punë, por meqenëse Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave nuk e ka nxjerrë aktin nënligjor siç përcaktohet me nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.04/L-230 të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent ku përcaktohet se: *“ Për zbatimin e këtij ligji ministri do të miratoj aktet nënligjore si në vijim: 1.3. Rregulloren për pagën bazë dhe shpërblimet tjera sipas nenit 13 të këtij ligji”* rrjedh se ligji në fjalë sa i përket nenit 13 të tij është i pamundur të zbatohet, dhe meqenëse as Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil dhe Ligjit Nr.04/L-230 nuk e kanë përcaktuar shtesën e shujtës ditore për ditë punë për nëpunësit civil, ankesa e ankuesve refuzohet si e pabazuar.

Po ashtu, Kolegji përveç pretendimeve ankimore për pagesën e shujtës ditore ka shqyrtuar edhe pretendimet shtesë të ankuesit lidhur me kompensimin e pagës jubilarë, ndërsa në bazë të shkresave të lëndës të ofruara nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave ka konstatuar se në bazë të kërkesës së datës 05.05.2016 në emër kompensimit për shpërblimin e përvjetorit (jubile) si dhe në bazë të listës së pagës së ankuesit për muajin maj 2016 i njëjti është kompensuar në vlerë prej njëqindedy euro (102€) në emër të shërbimit jubilar, nga rrjedh se me këtë rast institucioni punëdhënës i ka përmbushur obligimet ligjore ndaj ankuesit të përcaktuara me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil ku përcaktohet se: *“Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: shpërblimi i përvjetorit (jubile)”* dhe me Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil neni 21 ku përcaktohet se: *“Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune”*, ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara ngase ankuesi në vitin 2016 është shpërblyer për shërbimin jubile dhe nga vitit 2016 deri me tani nuk kanë kaluar ende dhjetë (10) vite.

Kolegji, përveç pretendimeve ankimore për pagesën e shujtës ditore ka shqyrtuar edhe pretendimet shtesë të ankuesve dhe lidhur me pagesën e pagave jubilarë, ndërsa në bazë të shkresave të lëndës të ofruar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave si dhe pas bisedës telefonike me Menaxherin e Personelit i njëjti e ka ri-konfirmuar se në dosjet e tyre me të cilat menaxhojnë nuk ka dëshmi nëse të njëjtëve iu është kompensuar pagesa për shpërblimin e përvjetorit (jubile), andaj Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, respektivisht Njësia e Burimeve Njerëzore obligohet që në



pajtim me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil ku përcaktohet se: “Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: shpërblimi i përvjetorit (jubile)” si dhe me Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil neni 21 ku përcaktohet se: “Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune”, ankuesve dhe të ua bëjë kompensimin në emër të shpërblimit të përvjetorit (jubile), andaj ky pretendim ankimor i ankuesve është i bazuar, ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore rreth kompensimit të shujtës ditore për ditë pune ankesa e ankuesve është e pabazuar dhe është refuzuar sipas arsytimit të pasqyruar në këtë vendim, andaj si përfundim ankesa e ankuesve dhe aprovohet pjesërisht si e bazuar e përcaktuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ndërsa, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesit

**sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresa të lëndës, respektivisht akt emërimeve të ankuesve si dhe deklarimit të statusit zyrtar të përcjellë nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave ka konstatuar se ankuesit:

dhe e kanë statusin e **Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës**, ndërsa bazuar në akt emërimit si dhe e-mailin e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik të datës 28.03.2022 është konstatuar se ankuesja e ka statusin **Nëpunës i Shërbimit Publik**.

Lidhur me kompetencën për shqyrtimin e ankesës së ankuesve të specifikuar si më lartë, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 paragrafi 3, 4 dhe 6 ku përcaktohet se: “3. **Nëpunës civil** - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë; 4. **Nëpunës i Shërbimit Publik** - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike; 6. **Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës** është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike” dhe si rrjedhojë duke u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të ankuesve, pozitave të tyre si dhe deklarimit të statusit zyrtar, Kolegji ka konstatuar se pozitat e ankuesve hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, ndërsa e ka statusin e nëpunës i shërbimit publik, respektivisht ankuesit nuk ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil të përcaktuar si në nenin 2 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm

ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesit e kanë statusin e nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës respektivisht një ankues e ka statusin e nëpunësit të shërbimit publik, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.151/2022 e 26.02.2022 për rastin e ankuesve

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, 1.3 si dhe nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë– Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.151/2022

**Flakron GASHI**



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesve, Avokati;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

